

Banka e Shqipërisë

TENDENCAT NË KREDITIM T3 - 2020

*Olta Manjani, Anjeza Gazidede, Erjona Suljoti dhe Sofika Note
Departamenti i Politikës Monetare, Banka e Shqipërisë*

TETOR 2020

*Pikëpamjet e shprehura në këtë material janë të autorëve dhe nuk
pasqyrojnë domosdoshmërisht ato të Bankës së Shqipërisë.*

P Ë R M B A J T J A

<i>HYRJE</i>	<i>4</i>
<i>PËRMBLEDHJE</i>	<i>5</i>
<i>1. KREDIA PËR BIZNESE</i>	<i>6</i>
<i>2. KREDIA PËR INDIVIDË</i>	<i>12</i>
<i>3. TENDENCAT E KREDITIMIT NË VENDET E RAJONIT</i>	<i>16</i>

HYRJE

Ky material synon të japë një panoramë të prirjes së aktivitetit kreditues në vend. Për ta përmbushur këtë qëllim, në të analizohen të dhënat monetare, si dhe kushtet e kreditimit, bazuar në Vrojtimin e Aktivitetit Kreditues. Pjesë e këtij materiali është edhe një përmbledhje e zhvillimeve të fundit të aktivitetit kreditues në disa nga vendet e Evropës Qendrore dhe Juglindore (EQJL).

Statistikat kryesore të analizuar në material janë: a) të dhënat për aktivitetin kreditues të bankave për sektorin rezident të ekonomisë; b) të dhënat cilësore të marra nga vrojtimi i aktivitetit kreditues; c) statistikatat për normat e interesit të kredisë, në monedhën vendase dhe në euro; d) të dhënat monetare për vëllimin e kredisë për vendet e rajonit. Vendet e përfshira në analizë janë: Bullgaria (BU), Kroacia (CR), Rumania (Ro), Serbia (Sr), Polonia (Pl), Hungaria (Hu), Republika Çeke (CZ), Republika e Maqedonisë së Veriut (RMV).

Të dhënat e kredisë merren nga bilanci të bankave dhe i referohen financimit të bankave vendase për sektorin privat rezident - bizneseve dhe individëve. Analiza e portofolit të kredisë bazohet në të dhënat e kredisë të rregulluara për efektin e kursit të këmbimit dhe për kreditë e fshira nga bilanci, proces të cilin bankat e kanë ndërmarrë bazuar në vendimin nr. 50, datë 30.3.2015, "Për ndryshimin e rregullores për administrimin e rrezikut të kredisë".

Materiali mbulon të dhënat e disponueshme deri më 23 tetor 2020, të cilat përfshijnë të dhënat monetare dhe financiare në vend, deri në muajin shtator 2020, dhe të dhënat e vrojtimin të aktivitetit kreditues për tremujorin e tretë të vitit 2020. Të dhënat e kredisë për vendet e rajonit janë deri në muajin gusht 2020.

Të dhënat e deritanishme financiare në vend tregojnë për një ndikim të përmbajtur të pandemisë mbi aktivitetin kreditues. Masat e marra nga qeveria dhe Banka e Shqipërisë për përballimin e pasojave të pandemisë kanë dhënë ndikim pozitiv, duke zbutur kështu efektet negative në aktivitetin kreditues.

PËRMBLEDHJE


Zhvillimet në aktivitetin kreditues, në tremujorin e tretë të vitit 2020, tregojnë se:

- *Kredia për sektorin privat vijon të rritet me ritme të qëndrueshme, e ndihmuar nga masat e marra nga autoritetet për nxitjen e saj. Këto masa kanë ndihmuar zgjerimin e portofolit të kredisë në lekë, duke çuar në rritjen e peshës të tij ndaj totalit.*
- *Ritmet e rritjes së kredisë për biznese kanë mbetur pranë nivelit mesatar të gjashtëmujorit të parë. Tremujori i tretë konfirmoi edhe njëherë rolin e masave të marra për të mbështetur bizneset në vështirësi nga pasojat e pandemisë Covid-19. Normat më të larta të rritjes së kredisë për korporatat kanë balancuar ngadalësimin e rritjes së kredisë për biznesin e vogël e të mesëm. Sipas sektorëve të ekonomisë, kredia për sektorin e shërbimeve, ndërtimit dhe të hotel - restoranteve shfaqti ecurinë më të mirë gjatë këtij tremujori.*
- *Kredia për individë ka shfaqur ngadalësim të ritmeve të rritjes për të tretin tremujor radhazi. Kjo ecuri është diktuar nga kontraktimi i shpejtë i ritmeve të rritjes së kredisë konsumatore. Ndërkohë, në tremujorin e tretë, kredia për banesa ka ruajtur norma të qëndrueshme rritjeje sikurse edhe në muajt e parë të vitit.*
- *Normat e interesit për kreditë e reja në lekë dhënë bizneseve kanë shënuar rritje në tremujorin e tretë të vitit, por mbeten më të ulëta se në tremujorin e parë, para uljes të normës bazë. Interesat e kredive për individë janë rritur për kreditë konsumatore, por mbeten të ulëta për ato hipotekare. Ndërkohë, interesi për kreditë në euro vijon të jetë relativisht i qëndrueshëm, si për bizneset, ashtu edhe për individët. Kushtet e tjera joçmim janë shtrënguar për bizneset dhe janë lehtësuar për individët në tremujorin e tretë të vitit.*
- *Aktiviteti kreditues në rajonin e EQJL-së është prekur nga pasojat e pandemisë Covid-19. Kredia për sektorin privat në këtë rajon ka ndjekur një trajektore ngadalësuese që nga muaji maj, duke shënuar tkurrje në segmentin e bizneseve dhe norma vjetore në ngadalësim në segmentin e individëve në periudhën korrik-gusht. Ecuria në terma gjeografikë shfaqet disi më heterogjene, ku kjo prirje është më e theksuar për vendet e Evropës Qendrore, ndërsa shënohen norma vjetore në rritje në disa prej vendeve të Ballkanit.*

1. KREDIA PËR BIZNESE¹

Kredia për biznese është rritur me ritme të qëndrueshme në tremujorin e tretë të vitit. Masat e marra për nxitjen e kreditimit e kanë mbështetur gjerësisht këtë grup. Kushtet monetare lehtësuese dhe skemat e kredisë me garanci sovraane kanë ndihmuar zhvendosjen e portofolit të kredisë për biznese drejt lekut.


Kredia për biznese është rritur në terma vjetorë me rreth 7% në tremujorin e tretë, normë kjo pranë mesatares së gjashtëmujorit të parë të vitit. Përmirësimi i ritmeve të rritjes për kredinë e korporatave ka balancuar ngadalësimin e kredisë për biznesin e vogël e të mesëm (NVM). Për të dytin tremujor radhazi, kredia për këtë grup ka shfaqur rritje të dobët tremujore, duke reflektuar si rënien më të fortë të kërkesës për kredi, ashtu edhe shtrëngimin e standardeve të kreditimit nga bankat. Bizneset e vogla e të mesme janë edhe grupi më i prekur nga pasojat e Covid-19. Kredia për biznesin e madh ka shfaqur ritme më të larta rritjeje, e ndihmuar edhe nga niveli më i lartë i kredive të reja të disbursuara për këtë grup.



Portofoli i kredisë për NVM-të është i mbizotëruar nga kredia në valutë, e cila ka ruajtur një peshë konstante rreth 55% në pesë vitet e fundit. Gjatë vitit 2020, rritja e shpejtë e kreditimit në lekë për këtë segment, ndihmoi në zgjerimin me 2.5 pikë përqindje të peshës së saj. Panorama shfaqet disi më ndryshe në kredinë për korporatat, ku zhvendosja e portofolit drejt kredisë në lekë ka qenë graduale në këto pesë vite. Në fund të muajit shtator, ky portofol përfaqësonte rreth 41% të kredisë për korporatat dhe ishte rreth 1.5 pikë përqindje më i lartë se në fund të muajit dhjetor 2019. Këto dinamika

¹ Të dhënat e kredisë për biznese janë të rregulluara për kreditë e nxjerra nga bilanci dhe për luhatjet e kursit të këmbimit.


reflekojnë lehtësimin e kushteve monetare, e shprehur në uljen e normave të interesit të kredisë në lekë prej disa vitesh. Gjithashtu, gjatë vitit 2020, kjo zhvendosje është ndihmuar edhe nga prezantimi i skemave të kreditimit me garanci shtetërore.



Dinamika e kreditimit brenda grupit të NVM-ve tregon se, gjatë periudhës së pandemisë, është tkurrur dukshëm kredia për bizneset mikro, ndërsa është konfirmuar rritja prej disa vitesh e kredisë për biznesin e mesëm. Në pesë vitet e fundit, bankat kanë zgjeruar gradualisht peshën e kredisë për biznesin me madhësi mesatare, duke ulur në të njëjtën kohë ekspozimin ndaj biznesit të madh. Gjatë vitit 2020, pesha e kredisë për biznesin e madh ndaj totalit të biznesit ka mbetur e pandryshuar nga fundi i vitit 2019, në rreth 52%. Këto zhvillime janë shoqëruar edhe me zhvendosjen e portofolit të NVM-ve drejt kredive me afat të gjatë maturimi. Ndërsa, për kreditë e biznesit të madh, struktura sipas maturitetit ka mbetur përgjithësisht e pandryshuar.

Në tremujorin e tretë, kredia për bizneset është mbështetur nga zgjerimi i portofolit në tre sektorët kryesorë: në tregti, hotele dhe restorante, në ndërtim dhe në atë të shërbimeve. Kredia për grupin e parë ka mbajtur një normë të ngjashme rritjeje me tremujorin paraardhës, prej 5.5%. Një kontribut të veçantë në këtë rritje ka dhënë zgjerimi i kredisë për hotele dhe restorante, i cili është një nga sektorët më të goditur nga pasojat e pandemisë Covid-19. Në fund të muajit shtator, pesha e këtij sektori ndaj kredisë për biznese arriti në 6.4%, ose rreth 2 pikë përqindje më shumë se mesatarja në vite. Ritmet e rritjes së kredisë për bizneset në sektorin e shërbimeve dhe të ndërtimit kanë qenë në trajektore pozitive deri në tremujorin e dytë, për të kthyer kah në tremujorin e fundit, ku shënuan përkatësisht 13.5% dhe 7.6%. Këto dinamika janë shoqëruar me zgjerimin e peshës së tyre ndaj totalit në përkatësisht 15.3% dhe 14.3%.

Grafik 3. Ecuria e kredisë për biznese sipas sektorëve të ekonomisë




Ndërkohë, sektori i industrisë ishte i vetmi sektor i cili u tkurr në krahasim me tre muaj më parë, duke konfirmuar shenjat ngadalësuese të normave të rritjes të nisur që para një viti. Peshë e kredisë për këtë sektor ndaj totalit u reduktua lehtësisht në 25.1%. Një peshë të ngjashme me fundin e vitit 2019 ka ruajtur edhe sektori i bujqësisë, i cili përfiton 1.4% të fondeve të akorduara bizneseve.

Normat e interesit për kreditë në lekë për bizneset kanë shënuar rritje në tremujorin e tretë të vitit, duke reflektuar ndikimin më të pakët të skemave me garanci shtetërore, por ato mbeten nën nivelet e tyre përpara uljes së normës bazë në muajin mars.

Norma mesatare e interesit për kreditë e reja dhënë bizneseve ka shënuar rritje në tremujorin e tretë të vitit. Ajo rezultoi mesatarisht 5.3%, nga 5.1% që ishte në tremujorin e dytë, por mbeti nën nivelin e tremujorit të parë, prej 5.5%. Rritja e normave të interesit, e vërejtur gradualisht në muajt gusht dhe shtator, u regjistrua kryesisht tek kreditë e vogla (deri në 35 mln lekë) dhe ato mesatare (35-140 mln lekë), ku normat kishin shënuar edhe rënien më të madhe në tremujorin e dytë të vitit. Ato rezultuan përkatësisht 5.3% dhe 4.9%, nga 4.6% dhe 4.4% që ishin një tremujor më parë. Ecuri të ndryshme kanë pasqyruar interesat për kreditë e mëdha (mbi 140 mln lekë), të cilat u rikthyen në nivelin mesatar të tremujorit të parë, prej 5.4%, pas rritjes në 6.0% në tremujorin e dytë.


Grafik 4. Ecuria e normave të interesit për kreditë në lekë për bizneset private



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Analiza sipas periudhës së fiksimit të normës së interesit² tregon se norma afatshkurtër e interesit pasqyron një dinamikë më pak të luhatshme në kohë. Gjatë vitit aktual, ajo ka qenë në rënie të vazhdueshme, duke zbritur në 5.8% dhe 5.4% në tremujorin e dytë dhe të tretë, pas mesatares relativisht të qëndrueshme prej 6.2% që prej gjysmës së dytë të vitit 2018. Teorikisht, ky është segmenti ku sinjalet e politikës monetare duhet të gjejnë edhe përcjelljen më të drejtpërdrejtë, në kushtet kur rreziku i kredisë nuk ndryshon.

Grafik 5. Ecuria e normave të interesit sipas kohës së fiksimit të normës së interesit



Burimi: Banka e Shqipërisë.


² Periudha e fiksimit nënkupton periudhën për të cilën norma e interesit të kredisë është fikse dhe nuk ndryshon. Një kredi mund të jepet: a) me normë interesi të ndryshueshme, b) për disa periudha fikse dhe më pas e ndryshueshme, ose c) fikse, përgjatë gjithë afatit të maturimit të saj. Për qëllim të kësaj analize, norma e interesit për kreditë e dhëna me normë të ndryshueshme dhe për ato me normë fikse deri në një vit është quajtur normë afatshkurtër; ajo për kreditë e dhëna me normë fikse mbi një vit dhe deri në 5 vjet është quajtur normë afatmesme; ajo për kreditë e dhëna me normë fikse mbi 5 vjet është quajtur normë afatgjatë. Në këtë mënyrë, koncepti afatshkurtër/afatgjatë lidhet me kohën në të cilën norma e interesit të kredisë është e pandryshuar apo fikse, dhe jo me maturitetin e kredisë.

Nga ana tjetër, normat e interesit fikse për një periudhë afatmesme apo afatgjatë, faktorizojnë, ndër të tjera, edhe pritjet për kursin e politikës monetare në të ardhmen, por primet e tyre përfshijnë një shumëllojshmëri rreziqesh, çka e bën të vështirë veçimin e një efekti të pastër të politikës monetare.

Gjatë këtij viti, vërehet një rritje e ndjeshme e vëllimit të kredive të dhëna me normë fikse përtej vitit të parë në periudhën maj-shtator, e cila përkon me përdorimin e skemave të kreditimit me garanci shtetërore. Pikërisht në këta muaj, norma e interesit për kreditë për biznese është ndikuar më së shumti nga normat afatmesme dhe afatgjata, të cilat i kanë dhënë trajektoren e fortë rënëse deri në muajin korrik, për t'u rritur më pas në gusht e shtator.


Normat e interesit për kreditë në euro kanë shënuar rënie këtë tremujor, pas rritjes në tremujorin e dytë, duke iu rikthyer kështu vlerave mesatare të tyre në tre vitet e fundit.

Norma mesatare e interesit për kreditë në euro të bizneseve ka shënuar rënie në tremujorin e tretë të vitit, në 5.1%, nga 5.3% që ishte në gjysmën e parë të vitit. Niveli aktual i tyre është i njëjtë me nivelin mesatar të viteve 2018 dhe 2019. Sipas madhësisë së kredisë, normat e interesit kanë shënuar luhatje të vogla për kreditë deri në 1 milion euro. Ndërkohë, interesi për kreditë më të mëdha se 1 milion euro ka rënë sërish pas rritjes së shënuar në tremujorin e mëparshëm, duke iu afruar niveleve mesatare të tremujorit të parë të vitit dhe të vitit 2019.



Kushtet joçmim janë shtrënguar në reflektim të rrezikut më të lartë të perceptuar nga bankat për këtë kategori.

Bankat vijojnë ta monitorojnë me kujdes situatën e shkaktuar prej pandemisë. Prania e rrezikut mbi treguesit kryesorë ekonomikë në vend vijon të jetë evidente. Për pasojë, marrëveshjet mbi kreditë e reja për biznese janë arritur duke toleruar një interval më të ulët rreziku krahasuar me tremujorët e mëparshëm. Tërësia e këtyre faktorëve së bashku kanë detyruar bankat të aplikojnë kushte e terma më të shtrënguara kreditimi në kreditë e reja që kanë aprovuar përgjatë tremujorit të tretë. Shtrëngimi i kushteve e termave të kreditimit është shfaqur si në elementet çmim – rritje e normave të interesit për kreditë e reja - ashtu edhe në ato joçmim.




Shtrëngimi i kushteve e termave të kreditimit joçmim për bizneset u arrit nëpërmjet: aprovimit të një madhësie më të ulët kredie nga ajo e kërkuar prej bizneseve; shtimit të kushtëzimeve në marrëveshjet e kredisë; si edhe rritjes së kërkesave për kolateral në raport me kredinë e marrë. Në të kundërt, bankat kanë zgjatur maturitetin maksimal të kredisë për biznese, e cila ka shërbyer si faktor në kahun lehtësues të kushteve e termave të kreditimit, por jo mjaftueshëm për të kundërbalancuar efektin shtrëngues që kanë pasur elementet e tjera joçmim të kredisë. Zgjatja e maturitetit të kredisë për bizneset, mund të lidhet edhe me masat lehtësuese në fuqi në tremujorin e tretë të vitit, të ndërmarra nga Banka e Shqipërisë dhe qeveria shqiptare, për të adresuar problemet e likuiditetit në bizneset e prekura nga pandemia. Riskedulimi i kredive të bizneseve – zgjatja e periudhës së ripagesave për kredinë e marrë – është parë edhe nga vetë bankat si një instrument i nevojshëm për kapërcimin e situatës për bizneset me historik krediti të shëndetshëm përpara pandemisë Covid-19.

2. KREDIA PËR INDIVIDË³

Kredia për individë ka shfaqur ngadalësim të normave të rritjes në tremujorin e tretë, e ndikuar nga ecuria e dobët e kredisë konsumatore.


Situata e krijuar nga pandemia e Covid-19, ka ndikuar negativisht në financimin e individëve me kredi nga bankat. Nga njëra anë vihet re reduktimi i fortë i kërkesës për financim si pasojë e pasigurisë për të ardhmen dhe zhvillimeve negative në tregun e punës. Nga ana tjetër, edhe bankat janë treguar të kujdesshme në zgjerimin e kredisë në këtë segment për shkak të rrezikut të perceptuar dhe kundërshtisë së tyre për të marrë përsipër më shumë rrezik. Në tremujorin e tretë të vitit, kredia për individë është rritur me 5.1% vmv, ose 1 pikë përqindje më pak se në tremujorin e dytë. Ngadalësimi i fortë i ritmeve të rritjes së kredisë për konsum ka përcaktuar këtë trajektore. Kjo ecuri është balancuar pjesërisht nga performanca pozitive e kredisë për blerje banese.



Portofoli i kredisë për individë mbizotërohet nga kredia për blerje banese, e cila zë rreth 64% të totalit. Në tremujorin e tretë, rritja e kredisë për individë ishte pothuajse e gjitha për blerje banese, dhe norma vjetore e saj shënoi rreth 7%, e ngjashme kjo me tremujorët paraardhës. Të dhënat e vrojtimit të aktivitetit kreditues tregojnë se në tremujorin e tretë, kjo kredi ka përfituar si nga përmirësimi i standardeve ashtu edhe nga kërkesa. Normat e ulëta të interesit, politikat e ndjekura nga bankat, si dhe ndërgjegjësimi i individëve për rrezikun e kursit mendohet se janë faktorët kryesorë që kanë ndikuar zhvendosjen drejt kreditimit në lekë të këtij portofoli (sikurse ilustron në Grafikon 9).

³ Të dhënat e kredisë për biznese janë të rregulluara për kreditë e nxjerra nga bilanci dhe nga luhatjet e kursit të këmbimit.

Grafik 9. Struktura e kredisë për individë sipas qëllimit të përdorimit




Burimi: Banka e Shqipërisë.

Në tremujorin e tretë, kredia konsumatore shënoi një rritje modeste prej 1.3%, duke shfaqur kështu normën më të ulët të rritjes në 3 vitet e fundit. Në veçanti, vihet re se kredia për konsum me afat të gjatë maturimi, është segmenti i goditur më fort. Peshë e këtij portofoli ndaj totalit, ra në 68% krahasuar me 71% në fund të vitit 2019. Ndërkohë, kredia afatshkurtër dhe ajo për overdraft pasqyruan një rritje të lehtë. Kredia konsumatore mbizotërohet nga kreditimi në monedhën vendase, i cili përbën 87% të totalit. Peshë e lekut ndaj totalit ka qenë e qëndrueshme në këto nivele përgjatë viteve të fundit.

Normat e interesit për kreditë në lekë për individë janë rritur për kreditë konsumatore në këtë tremujor, ndërkohë që mbeten në nivele të ulëta për kreditë hipotekare. Interesi për kreditë në euro mbetet i qëndrueshëm.


Grafik 10. Ecuria e normave të interesit për kreditë në lekë për individët



Burimi: Banka e Shqipërisë.


Norma mesatare e interesit për kreditë në lekë për individë u rrit në tremujorin e tretë të vitit, pas rënies së shënuar një tremujor më parë. Ajo rezultoi 6.4%, nga 5.9% që ishte në tremujorin e dytë të vitit, duke qëndruar gjithsesi në nivelin e tremujorit të parë, prej 6.8%. Dinamika e normës mesatare të interesit të kredisë gjatë këtij viti është ndikuar tërësisht nga interesat e kredisë konsumatore. Këto të fundit, pas rënies në tremujorin e dytë të vitit, në 7.2%, u rritën sërish në tremujorin e tretë, duke kapur nivelet e tremujorit të parë të vitit, prej rreth 8.2%.

Norma e interesit për kreditë hipotekare ka qëndruar e pandryshuar në tre tremujorët e parë të këtij viti, në mesatarisht 4.5%. Vetëm rreth 1/3 e kredisë hipotekare lëvrohet me normë interesi të ndryshueshme apo të fiksuar vetëm për vitin e parë; rreth 50% e saj lëvrohet me normë fikse interesi për 1-5 vjet, dhe pjesa tjetër me normë fikse për më shumë se 5 vjet. Në përgjithësi, vërehet se norma afatshkurtër e interesit për kreditë hipotekare, përveç se është më e ulëta, është edhe më pak e luhatshme krahasuar me normat e interesit të fiksuar në afat të gjatë. Ajo ka rezultuar mesatarisht 3.8% në tremujorin e tretë të vitit, nga 4.0% në gjysmën e parë të këtij viti dhe në vitin 2019. Normat e interesit të fiksuar për 1-5 vjet dhe për mbi 5 vjet janë përgjithësisht më të larta dhe më të luhatshme, duke reflektuar pasigurinë që materializohet në fiksimin e tyre.



Norma mesatare e kredive në euro për individë mbetet e qëndrueshme në këtë tremujor, në 4.1%, sa edhe në gjysmën e parë të vitit dhe në vitin 2019. Sipas qëllimit të përdorimit, norma e interesit për kreditë hipotekare vijon ruajtje të njëjtin nivel, prej 4.0%, gjatë gjithë këtij viti. Norma e interesit për kreditë konsumatore ka shënuar rënie të mëtejshme, duke zbritur në nivelin 4.2% në këtë tremujor, nga 4.4% dhe 4.9% që shënonte përkatësisht në tremujorin e dytë dhe të parë të vitit. Diferenca e interesit të kredisë në lekë me atë në euro për individët është luhatur rreth mesatares 2.3 pikë përqindje gjatë këtij viti, sa edhe në vitin 2019. Për kredinë hipotekare, kjo diferencë është minimale, në 0.4 pikë përqindje.

Grafik 12. Ecuria e normave të interesit për kreditë në euro për individët




Burimi: Banka e Shqipërisë.

Kushtet e termat e kreditimit për kreditë e reja akorduar individëve në tremujorin e tretë u lehtësuan.

Në tërësi, kushtet e termat e kreditimit për kreditë e reja akorduar individëve në tremujorin e tretë u lehtësuan. Rezultati i agreguar nga përgjigjet e 10 bankave të sistemit bankar u diktua nga një bankë e vetme. Kushtet e termat e kreditimit konvencionale joçmim ishin të pandryshuara për kreditë e reja për individët. Faktori i vetëm që drejtoi lehtësimin e tyre në këtë tremujor ishte përmirësimi i analizës së rrezikut për klientët ekzistues. Ky faktor tejkaloi edhe efektin shtrëngues mbi termat e përgjithshme të kreditimit nga aplikimi i marzheve – normave të interesit - më të larta në kreditë me rrezik për individët.

Grafik 13. Kushtet joçmim për kreditë e reja të individëve




Për informacion më të detajuar, lutemi referojuni rubrikës mbi vrojtimin e aktivitetit kreditues në linkun: https://www.bankofalbania.org/Politika_Monetare/Vrojtimet/Vrojtimi_i_aktivitetit_kreditues/.

Burimi: Banka e Shqipërisë, llogaritje të stafit.

3. TENDENCAT E KREDITIMIT NË VENDET E RAJONIT⁴

Kredia për sektorin privat në vendet e rajonit ka ndjekur një trajektore ngadalësuese që nga muaji maj, duke shënuar tkurrje në segmentin e bizneseve dhe ngadalësim në atë të individëve.

Portofoli i kredisë për sektorin privat shënoi një normë mesatare vjetore prej 0.6% në muajt korrik dhe gusht, rreth 1.6 pikë përqindjeje më e ulët krahasuar me tremujorin e dytë të vitit. Pas shenjave të para të ngadalësimit që u vunë re në muajin maj, kredia për sektorin privat ka mbetur në trajektore ngadalësuese. Ngadalësimi i normave të rritjes së këtij portofoli reflekton, ndër të tjera, pasiguritë e shtuara për të ardhmen në kuadër të pandemisë Covid-19. Zhvillimet në terma gjeografikë tregojnë për ecuri heterogjene të kredisë për sektorin privat në këtë rajon. Vende të ndryshme të rajonit kanë ndërmarrë paketa të ndryshme masash për minimizimin e pasojave të pandemisë Covid-19⁵. Krahas paketave për mbështetjen e kreditimit të individëve dhe bizneseve – në formën e garancisë sovrane – nëpërmjet sistemit bankar, në disa prej këtyre vendeve janë miratuar dhe paketa që u ofrojnë mbështetje të drejtpërdrejtë këtyre agjentëve ekonomikë, pa ndërmjetësim financiar.




Kështu, në vende si Kroacia, Maqedonia dhe Serbia, portofoli i kredisë për sektorin privat ka shënuar norma vjetore në rritje krahasuar me tremujorin e dytë të vitit. Ndërkohë, pjesa tjetër e vendeve të Ballkanit dhe ato të Evropës Qendrore kanë shënuar norma në ngadalësim ose në rënie, e cila mund të

⁴ Në këtë analizë përfshihen 9 vende të rajonit të Evropës Qendrore dhe Juglindore: Shqipëri, Maqedoni e Veriut, Kroaci, Serbi, Bullgari, Rumani, Çeki, Poloni dhe Hungari. Stoku i kredisë për sektorin privat është i rregulluar për efektin e inflacionit dhe kursit të këmbimit.

⁵ Për një përmbledhje të këtyre masave, referojuni hapësirës informuese në materialin "Tendencat në kreditim T1'20": https://www.bankofalbania.org/rc/doc/Tendencat_ne_kreditim_prill_2020_web_16918.pdf

lidhet pjesërisht me format alternative të financimit jashtë sistemit bankar. Në vërtetimin e fundit të aktivitetit kreditues në vendet e rajonit⁶ (tetor'10-mars'20), bankat kanë rishikuar pritjet e tyre për zhvillimet në gjashtëmuorin në vijim (prill'20-shtator'20), si pasojë e përhapjes së pandemisë. Ato janë shprehur për shtërngim të ofertës, pritje për rënie të kërkesës, reduktim të raportit të aprovimit të kredive, si dhe rënie të cilësisë së aplikimeve për kredi. Pritjet për kërkesën janë parashikuar në territor negativ për herë të parë pas gjashtë vjetësh. Materializimi i mundshëm i këtyre pritjeve në pjesën më të madhe të rajonit të EQJL-së duket të ketë ndikuar në ngadalësimin e normave vjetore të portofolit të kredisë për sektorin privat.



Kredia për biznese në rajonin e EQJL-së është prekur më shumë nga pasojat negative dhe efektet zinxhir të pandemisë Covid-19, duke hyrë në territor negativ që nga muaji qershor. Kreditimi i këtij segmenti ka qenë prioritet i masave të ndërmarra nga qeveritë dhe bankat qendrore përkatëse për zbutjen e efekteve të pandemisë. Në periudhën korrik-gusht, portofoli i kredisë për biznese shënoi tkurrje me rreth 1.6%. Sipas vërtimit të fundit të aktivitetit kreditues në rajon, disa nga faktorët e kërkesës dhe ofertës që priteshin me ndikim pozitiv në raundin paraardhës, pas përhapjes së pandemisë, kanë kaluar në territor negativ. Në kahun e kërkesës, bankat janë shprehur për tkurrje të kërkesës së bizneseve për kredi për investime dhe ruajtje në nivele të ngjashme të kërkesës për kredi për kapital qarkullues në periudhën prill'20-shtator'20. Në kahun e ofertës, pritjet janë gjithashtu në territor negativ për të njëjtën periudhë, thuajse në të gjitha segmentet e tregut, si për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme, ashtu edhe për bizneset e mëdha. Zhvillimet në terma gjeografikë tregojnë për tkurrje në terma vjetore të portofolit të kredisë për biznese në rajonin e Evropës Qendrore. Kjo ecuri është ndikuar nga reduktimi i këtij portofoli në Poloni dhe Çeki, si dhe nga ngadalësimi i normave të rritjes në Hungari.

⁶ Rezultatet e vërtimit të aktivitetit kreditues së EIB jepen të detajuara në adresën në vijim https://www.eib.org/attachments/efs/economics_cesee_bls_2020_h1_en.pdf

Stoku i kredisë për individë shënoi rritje vjetore me rreth 2.1% në muajt korrik-gusht, krahasuar me normën prej 3% në tremujorin e dytë të vitit. Megjithatë, pavarësisht pritjeve më pesimiste në segmentin e individëve krahasuar me atë të bizneseve, zhvillimet në këtë portofol karakterizohen nga një inerci më pozitive. Pritjet për shtrëngim të kushteve të ofertës dhe tkurrje të kërkesës duket të jenë materializuar pjesërisht. Kjo ecuri vërehet edhe në rritjen e stokut të kredisë për individë në terma absolutë nga muaji qershor në të gjitha vendet e rajonit, ndryshe nga portofoli i kredisë për biznese që ka shënuar tkurrje në disa prej tyre për të njëjtën periudhë. Përgjithësisht, portofoli i kredisë për individë shfaq ecuri më të qëndrueshme dhe të njëtrajtshme, si në terma gjeografikë, ashtu edhe në kohë. Zgjerimi i këtij portofoli udhëhiqet nga rritja e shpejtë e këtij portofoli në rajonin e Ballkanit.

